



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI

RAPORT VJETOR 2022

Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak Has për vitin 2022

Janar 2022

Në muajin Janar është mbajtur mbledhja e rradhës me date 28.01.2022. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Dhjetor 2021 160 familje me një fond prej 613,320 lekë. Janë miratuar kriteret për familjet që do të trajtohen me fondin deri në 6% për vitin 2022. Është miratuar raporti i monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e tretë dhe të vitit 2021. Është miratuar një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has. Është miratuar vendimi për ndryshimin e numrit të punonjësve të funksioneve të deleguara. Është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të disa pajisjeve inventar ekonomik dhe imet për Bashkinë Has, njesinë Ad. Fajza dhe Golaj për vitin 2021. Janë miratuar kërkesat e bashkisë për mbështetje financiare të shtetasve Muhamet Cahani, Astrit Geca, Jetnor Gjoni. Është miratuar lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë dhe vlera maksimale e subvencionimit të qirase dhe të nivelit të qirase mesatare në treg të lirë. Është miratuar lista e projekteve për investim për vitin 2022 e në vazhdim. Është miratuar kërkesa nga shoqëria "Blerimi Kosturr 2010". Është miratuar plani vjetor I aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Has 2022. Janë trajtuar disa kërkesa të banorëve.

Shkurt 2022

Në muajin Shkurt mbledhja e rradhës është mbajtur me datë 25.02.2022. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Janar 166 familje me një fond prej 790,158 lekë. Është miratuar lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë. Është miratuar lidhja e marrëveshjes specifike me ministrinë e infrastrukturës dhe energjisë për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e uerua të ndotura në zonat e shërbimit në territorin e Hasit. Janë miratuar kërkesat për shpallje qytetarënderi qytetarët Rexhep Xhota dhe Haziz Hodaj. Është miratuar rishpërndarje e fondeve të pagave në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2022.

Mars 2022

Në muajin Mars është mbajtur me datë 30.03.2022. Është miratuar lista e personave që kanë përfituar nga fondi 6%. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Shkurt 2022 172 familje me vlerë 852,546 lekë. Është miratuar lista për trajtimin me bonus strehimi për disa qytetarë. Janë miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetit afatmesëm 2023-2025. Është miratuar pagesa e menjehershme për shpenzime transporti fëmijë autik. Është miratuar shesh depozitimi i mbetjeve dhe inerteve të Fshatit Letaj. Është miratuar heqja nga fondi pyjor/kullësor publik për objekt të aktivitetit mineral, të sipërfaqes prej 0.91 ha, në ngastren 88/a, 89/a, 97/d, në ekonomine Helshan të Bashkisë Has që zë hyrja e Galerive nga shoqëria "Blerimi Kosturr 2010". Është miratuar plani i mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Has të vlefshme për 10 vite. Është miratuar kërkesa për ndërtim rrugë Kishaj- Kodra e madhe. Janë miratuar kërkesat e bashkisë për mbështetje financiare të shtetasve Alush Kuka dhe Jetmir Sokoli.

Tetor 2022

Në muajin Tetor mbledhja e rradhës është mbajtur me datë 27.10.2022. Janë trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin Shtator, 175 familje me një fond 878,782 lekë. Janë trajtuar me bonus strehimi disa familje në nevojë. Eshte miratuar rishperndarje ne buxhetin e Bashkise Ha per vitin 2022. Janë miratuar kërkesat e bashkisë për mbështetje financiare të shtetasve Iljaz Kastrati, Dem Cenalia. Janë miratuar disa ndryshime ne VKB-ne Nr.79, dt 22.12.2021

Nëntor 2022

Në muajin Nëntor mbledhja e rradhës është mbajtur me datë 30.11.2020. Janë trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin Tetor, 173 familje me një fond 985,062 lekë. Janë trajtuar me bonus strehimi disa familje në nevojë. Eshte miratuar plani i aktivitetit te Keshillit Bashkiak Has per vitin 2023. Eshte miratur nje shtese ne numrin e punonjesve ne strukturen e Bashkise Has per vitin 2022. Eshte miratuar kerkesa per privatizimin, objektit, ish Ambulanca e Vjeter Krume.

Dhjetor 2022

Në muajin Dhjetor mbledhja e rradhës është mbajtur me datë 22.12.2022. Janë trajtuar me ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin Nentor, 176 familje me një fond 328,526 lekë. Janë miratuar bursat e ndermjetme, bursat profesionale dhe bursat e vitit te I Gjimmnazi "Skenderbeu". Janë miratuar bonuset e strehimit per disa familje në nevojë. U miratua nje shtese ne buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022. U miratua per nxjerrjen jashte perdorimit te disja paisjeve inventar ekonomik dhe imet per Bahkine Has, njesine Ad Fajza, dhe njesine Golaj per vitin 2022. U miratua sistemi i taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Has per vitin 2023. U miratua VKB per numrin e punonjesve te Bashkise, insitucioneve ne vartesi, njesive administrative dhe klasifikiminb e pagave te administrates dhe punonjesve te tjere per vitin 2023. Eshte miratuar buxheti i Bashkise Has per vitin 2023 dhe PBA vitit 2023-2025. U miratua kerkesa per ngritjen e memorialit te Mbretreshes Elizabet ne sheshin Haradinaj. U miratua kalendari orientues per menaxhimin e shpenzimeve vendore gjate vitit 2023.

SEKRETARI KËSHILLIT

JETMIR CAHANI

KRYETARI KËSHILLIT

SHEFQET DAUTI